

## **INFORMACION PËR KOMISIONET QË APLIKOHEN NGA BANKA E TIRANËS NË VEPRIMET ME TITUJT**

Banka e Tiranës Sh. A njofton komisionet që do të aplikohen për klientët e tyre për veprimtarinë e tregimit të titujve të Qeverisë së Shqipërisë si më poshtë:

Klientët tanë, nëpërmjet bankës sonë mund të kryejnë një sërë transaksionesh në lidhje me titujt e Qeverisë Shqiptare si pjesëmarrje në ankandet e titujve në treg primar dhe blerje shitje titujsh në tregun sekondar.

### ***Tregu primar i titujve të Qeverisë së Shqipërisë***

Investimi në tituj nëpërmjet Bankës Tirana në tregun primar .

- Nëse një klient shpreh dëshirën për të investuar në Bono Thesari në tregun primar nëpërmjet Bankës Tirana, komisioni i ndërmjetësimit që aplikohet është:

3,000 ALL për investimet nga 300,000 ALL - 1,000,000 ALL

5,000 ALL për investimet mbi 1,010,000 ALL.

- Nëse një klient shpreh dëshirën për të investuar në ankand të obligacioneve të Qeverisë Shqiptare në tregun primar nëpërmjet Bankës Tirana, komisioni i ndërmjetësimit që aplikohet varion në varësi të viteve të maturimit të obligacionit.

Komisionet që aplikohen janë:

8,000 ALL për investimet në obligacione 2 vjeçare.

8,000 ALL për investimet në obligacione 3 vjeçare

10,000 ALL për investimet në obligacione 5 vjeçare

15,000 ALL për investimet në obligacionet 7 vjeçare

15,000 ALL për investimet në obligacionet 10 vjeçare.

Për investimet në tituj në monedhe të huaj nëpërmjet Bankës Tirana në tregun primar, komisionet që aplikohen janë:

Investime në Bono thesari në EUR /USD investitori paguan 50 EUR.

Investime në Obligacione në EUR/USD investitori paguan 70 EUR.

Këto komisione janë të njëjta për individë dhe për personat fizikë.

Investitori paguan për kërkesë dhe një herë të vetme, përpara zhvillimit të ankandit të titujve.

Për personat fizikë aplikohet një komision vjeçar kujdestarie i barabartë me 0.15% të vlerës nominale të portofolit të zotëruar nga investitori. Komisioni aplikohet çdo 3 muaj.

### ***Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë së Shqipërisë***

Për blerje/shitjen e titujve të Qeverisë në tregun sekondar, nuk aplikohet komision nga Banka e Tiranës. Banka e Tiranës nuk aplikon komision as për transferim portofoli të investitorëve nga Banka e Tiranës në banka të tjera.

- *Shitja e bonos së thesarit një investitori nga portofoli i bankës.*  
Klientit do t'i llogaritet çmimi i shitjes së bonos së thesarit në bazë të yieldit të shitjes të kuotuar nga banka për ditët e mbetura deri në maturimi të bonos së thesarit.

#### ***Shembull:***

Një klient do të investojë pranë Bankës Tirana, një shumë 3,000,000 lekë në një Bono Thesari 12 mujore, me ditë të mbetura deri në maturimi 140, duke pasur parasysh që yield-i në shitje i dhene nga banka është 1.80%, çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i shitjes} = \frac{3,000,000}{\left(1 + 1.8\% \cdot \frac{140}{365}\right)}$$

$$\text{Çmimi} = 2,979,429.69 \text{ lekë}$$

- *Blerja e titujve nga banka para datës së maturimit nga çdo investitor, pavarësisht nëse veprimet e mëparshme nuk janë kryer nga e njejta bankë apo subjekt i licensuar;*

Në rastin kur klienti dëshiron të shesë një titull të Qeverisë, pranë Bankës Tirana, para datës së maturimit Banka Tirana nuk aplikon komision.

Në këtë rast, çmimi i blerjes së titullit do të llogaritet në bazë të yield-it të dhene nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim. Obligacionet shiten me premium/discount ndaj vlerës së tyre nominale.

Kuotimet për yieldin e Obligacioneve të thesarit luhaten në varesi të tregut.

#### ***Shembull:***

Nëse një klient do të shesë para afatit të maturimit një Obligacion me kupon 7.5% që paguhet çdo gjashtë muaj, me 141 ditë të mbetura deri në maturim, me vlerë nominale 1,000,000 lekë, nëse yield-i në blerje që banka ka kuotuar është 6.80%, atëherë çmimi llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i obligacionit} = \frac{K}{2} \left[ \frac{1 - \left(1 + \frac{y}{2}\right)^{-2t}}{\frac{y}{2}} \right] + \frac{VN}{\left(1 + \frac{y}{2}\right)^{2t}}$$

Ku:

K= Vlera e kuponit = 7.5% \* 1,000,000 leke = 75,000 leke

T= vitet e mbetura deri në maturim = 141/365 = 0.3863 vite

Y = yieldi i kuotuar nga banka = 6.80%

VN= Vlera Nominale = 1,000,000 leke

Mbas llogaritjes çmimi i obligacionit do të jetë: 1,002,625.10